



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Zubin Potokut
Opština Zubin Potok - Municipality of Zubin Potok**

KUVENDI I KOMUNËS SË ZUBIN POTOKUT

Nr. _____ Dt. ____ / ____ / _____

Zubin Potok

DRAFT STATUTI I KOMUNËS SË ZUBIN POTOKUT

Korrik, 2025

KUVENDI I KOMUNËS SË ZUBIN POTOKUT

Nr. _____ **Dt.** ____ / ____ / _____

Zubin Potok

Në bazë të nenit 12, paragrafin 2, nenparagrafin a, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.28/ 04 Qershor 2008); Kuvendi i Komunës së Zubin Potokut në mbledhjen e mbajtur më dt. _____ pasi shqyrtoi Statutin e Komunës të miratuar në parim, miratoi:

DRAFT STATUTI I KOMUNËS SË ZUBIN POTOKUT

KAPITULLI I

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

1. Statuti i Komunës së Zubin Potokut (në tekstin e mëtejshëm statuti) është akti më i lartë juridik i Komunës së Zubin Potokut (në tekstin e mëtejshëm komuna), me të cilin përcaktohen:
 - 1.1.themelimi i bazës juridike të qeverisjes me vetëqeverisje së Komunës;
 - 1.2.kompetenca, parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimi dhe funksionimi të organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunës dhe bashkëpunimi me komunat tjera, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunës dhe pushtetit qendror.
2. Ky statut zbatohet në territorin e Komunës, të përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave.

KAPITULLI II

Komuna

Neni 2

1. Komuna është njësi themelore territoriale, administrative e Republikës së Kosovës. Në komunë realizohet e drejta për vetëqeverisje lokale në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe në interes të të gjithë qytetarëve të Komunës. Kjo e drejtë realizohet në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të parashikuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për vetëqeverisjen lokale, dispozitat ligjore dhe nenligjore që rregullojnë funksionimin e pushtetit lokal dhe dispozitat e këtij statuti.
2. Të gjitha organet e Komunës kujdesen që qytetarët e Komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë që ndërlidhen me racën, etninë, ngjyrën, gjininë, gjuhën, religjionin, mendimin politik apo mendimin tjetër, dhe për çdo lloj diskriminimi, si dhe që qytetarët të kenë një status të barabartë dhe mundësi të barabarta për shërbimet komunale në të gjitha nivelet.

3. Komunat i zbatojnë politikat dhe praktikat për të mbështetur bashkëjetesën dhe paqen ndërmjet qytetarëve të tyre dhe për të krijuar kushte të përshtatshme që u mundësojnë të gjithë komuniteteve për t'i shprehur, ruajtur, zhvilluar identitetet e tyre etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore.
4. Të gjitha autoritetet komunale u përgjigjen qytetarëve të Komunës në format e përcaktuara me ligj.
5. Qytetarët e Komunës kanë të drejtë që të marrin pjesë në aktivitetet e Komunës, siç përshkruhet me ligj.
6. Komuna ka të drejtë të lidhë marrëveshje me fshatrat, lagjet apo vendbanimet brenda territorit të tyre për t'u ofruar më afër shërbime qytetarëve, në pajtim me nenin 35 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe këtij Statuti.

Neni 3

1. Komuna është person juridik.
2. Selia e Komunës është në Zubin Potok, rruga Kolashinskih Knezheva numër 17.
3. Komuna është bartëse e së drejtës:
 - 3.1.për të poseduar dhe menaxhuar pronën e paluajtshme dhe pronën e llojshme të Komunës;
 - 3.2.të jetë pronare apo bashkëpronare e ndonjë kompanie në interes të Komunës dhe qytetarëve;
 - 3.3.për të ushtruar padysim deri për çështje e paditur në gjykata;
 - 3.4.të hyjë në marrëdhënie kontraktues;
 - 3.5.të marrë punëtorë në punë dhe të ushtrojë përgjegjësi tjera të cilat nuk janë të kompetencë të Pushtetit Qendror.

Neni 4

Qytetar i Komunës është çdo shtetas i Republikës së Kosovës me vendbanim në territorin e Komunës.

Neni 5

1. Komunën e Zubin Potokut përveç qytetit me lagjet urbane e përbëjnë edhe fshatrat me zonat kadastrale si në vijim:
 - 1.1. Babiq;
 - 1.2. Badudovicë;
 - 1.3. Banje;
 - 1.4. Bojnoviq;
 - 1.5. Brnjak;

- 1.6. Bube;
- 1.7. Burlate;
- 1.8. Çabër;
- 1.9. Çeçevë;
- 1.10. Çitluk;
- 1.11. Crepuljë;
- 1.12. Dobroshevina;
- 1.13. Dragaljica;
- 1.14. Drainoviq;
- 1.15. Dren;
- 1.16. Gazivodë;
- 1.17. Jabukë;
- 1.18. Jasenovik i Poshtëm;
- 1.19. Jasenovik i Epërm;
- 1.20. Jegenicë;
- 1.21. Junakë;
- 1.22. Kaludra e Epërme;
- 1.23. Kaludra e Vogël;
- 1.24. Kërligatë;
- 1.25. Kijevce;
- 1.26. Kleqke;
- 1.27. Kobila Glavë;
- 1.28. Kopiloviq;
- 1.29. Kovaqë;
- 1.30. Kozarevë;
- 1.31. Ledenik;
- 1.32. Luqka Rekë;
- 1.33. Megjegji Potok;
- 1.34. Oklace;
- 1.35. Padine;
- 1.36. Paruce;
- 1.37. Prelez;
- 1.38. Preseka;
- 1.39. Prevlakë;
- 1.40. Pridvoricë;
- 1.41. Qeshanoviq;
- 1.42. Ranqiq;
- 1.43. Rezala;
- 1.44. Rujishtë;
- 1.45. Shipovë;
- 1.46. Shtuoce;
- 1.47. Stermci i Epërm;
- 1.48. Tushice;
- 1.49. Ugljar;
- 1.50. Varaga e Epërme;
- 1.51. Varaga e Poshtme;

- 1.52. Veli Breg;
- 1.53. Vitakovo;
- 1.54. Vojmislice;
- 1.55. Vrba
- 1.56. Vukojevice;
- 1.57. Vukosavljevice;
- 1.58. Zagragjë;
- 1.59. Zagulj;
- 1.60. Zeqeviq;
- 1.61. Zharevë;
- 1.62. Zubin Potok; dhe
- 1.63. Zupq.

- 2. Me vendim të posaçëm të Kuvendit, mund të përcaktohen lagje dhe vendbanime tjera në territorin e Komunës.

Neni 6

Ndryshimi i kufijve të Komunës mund të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave në Republikës e Kosovës.

Neni 7

Simbolet, Vulat dhe Festat

- 1. Komuna e Zubin Potokut e ka vulën, **emblemën dhe flamurin** e vet.
- 1.1. Komuna ka vulën e rumbullakët dhe vulën katrore të protokollit, dimensionin e vulave është sipas Ligjit për përdorimin e vulave:
 - 1.1.1. Vula e rumbullakët përmban tekstin: rrethi i parë: Republika e Kosovës, rrethi i dytë: Komuna e Zubin Potokut dhe në mes të vulës duhet të jetë emblem e Kosovës.
 - 1.1.2. Vula e Protokollit të Komunës ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë me dimensione të përcaktuara sipas Ligjit për Përdorimin e Vulave me tekstin: Republika e Kosovës – Komuna e Zubin Potokut, Nr. _____, datë _____.
- 1.2. Vulat e Komunës të përshkruara në pikat 1 dhe 2 të paragrafit 1 të këtij neni tekstin duhet ta kenë të shkruar në gjuhët zyrtare të përcaktuara me ligj.
- 1.3. Mënyra e mbajtjes dhe përdorimit të vulave të Komunës përcaktohet me vendim të posaçëm të Kryetarit të Komunës, i cili kërkon një pajtim me aktet ligjore të cilat rregullojnë këtë çështje, i cili e autorizon personin përgjegjës me shkrim që do të përdorë vulën.
- 2. Komuna e Zubin Potokut do ta miratojë stemën e saj pasi të kryhen procedurat paraprake në përputhje me ligjin.
- 3. Komuna e Zubin Potokut do ta miratojë flamurin e saj pasi të kryhen procedurat

paraprake ne perputhje me ligjin.

4. Komuna shënon festat shtetërore e kombëtare sipas kalendarit të festivave në Republikën e Kosovës dhe festat komunale.
5. Komuna e Zubin Potokut si ditë të saj e ka 30 Qershorin, dita e ri-formimit të komunës së Zubin Potokut.
6. Festat e Komunës shënohen me organizimin e seancave solemne të Kuvendit dhe manifestime të ndryshme kulturore e sportive.
7. Forma, përmbajtja dhe përdorimi i simboleve të Komunës përcaktohet me rregullore të veçantë të Kuvendit të Komunës.
8. Simbolet e Komunës miratohen dhe ndryshohen nga Kuvendi i Komunës me 2/3 (dy të tretat) e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në pajtim me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore të Republikës së Kosovës, dhe nuk duhet të përfshijnë simbolet e shteteve tjera apo komunave tjera të Kosovës.

Neni 8 Gjuhët

1. Në komunë gjuhë zyrtare janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe.
2. Komuna në pajtim me Ligjin për Përdorimin të Gjuhëve miraton Rregullore të veçantë për përdorimin e gjuhëve brenda territorit të Komunës.

Neni 9 Titujt e Nderit, Çmimet, Mirënjohjet dhe Falënderimet

1. Kuvendi ndan tituj të nderit, çmime, mirënjohje, falënderime dhe shpërblime.
2. Me Rregullore të veçantë të Kuvendit, përcaktohen titujt e nderit, çmimet, mirënjohjet dhe falënderimet kushtet dhe mënyra e dhënies.

Neni 10 Organet e Komunës

1. Organet e Komunës janë:
 - 1.1. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës i Komunës, dhe
 - 1.2. Kryetari i Komunës është organi më i lartë ekzekutiv i Komunës.

Neni 11

1. Kuvendi i Komunës dhe Kryetari kanë të drejtën të miratojnë akte dhe të ndërmarrin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre.
2. Të gjitha aktet e Komunës duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.

3. Publikimi në ueb faqen zyrtare të Komunës i akteve normative të Komunës me karakter të përgjithshëm është i obligueshëm.
4. Aktet normative dhe vendimet e organeve të Komunës dërgohen në njësinë përgjegjëse për publikim në ueb faqen zyrtare të komunës në formën elektronike, në gjuhët zyrtare dhe në formatin e përcaktuar nga njësi/a/zyrtari përgjegjës/e për publikim të aktit normativ dhe vendimet e organeve të komunës.

Neni 12

Aktet e Kuvendit të Komunës

1. Kuvendi i Komunës mund të miratojë akte brenda fushës së kompetencave të tij, këto akte përfshijnë:
 - 1.1.Statutin e Komunës;
 - 1.2.Rregulloren e punës;
 - 1.3.Rregullore komunale;
 - 1.4.Vendime;
 - 1.5.Marrëveshjet e bashkëpunimit;
 - 1.6.Aktet tjera që parashihen me ligje të tjera; dhe
 - 1.7.Çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionimin efikas të Komunës.
2. Kuvendi e miraton Statutin dhe e ndryshon atë nëse konsideron se një ndryshim i tillë është i nevojshëm.
3. Çdo vendim për miratimin apo për ndryshimin e statutit, merret me 2/3 (dy të tretat) e votive të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit.
4. Kuvendi e miraton Rregulloren e punës së Kuvendit dhe mund ta ndryshojë atë nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Rregullores së punës së Kuvendit, merret me votimin e shumicës së anëtarëve Kuvendit të Komunës. (50% + 1).
5. Propozues të akteve normative të Komunës janë:
 - 5.1.Kryetari i Komunës si dhe drejtoritë komunale;
 - 5.2.Kryesuesi i Kuvendit të Komunës;
 - 5.3.Komitetet e Kuvendit të Komunës;
 - 5.4.Anëtarët e Kuvendit të Komunës;
 - 5.5.Pesëmbëdhjet për qind (15%) e qytetarëve të komunës me të drejtë vote.
6. Shfuqizimi, plotësim-ndryshimi i një akti normative të kuvendit bëhet me akt të njëjtë duke respektuar procedurat ligjore.

Neni 13

Aktet e Kryetarit të Komunës

1. Kryetari i Komunës ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime brenda fushës së kompetencave të tij.

2. Të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës që ndikojnë drejtpërdrejt në interesat e qytetarëve pas nënshkrimit publikohen në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Neni 14

Pasuria e Komunës

1. Komuna ka të drejtë të posedojë dhe menaxhojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.
2. Komuna ka të drejtë të shesë dhe të japë me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme sipas ligjit, me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të veçantë.
3. Komuna mbanë dhe udhëheq regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që e kanë në shfrytëzim dhe posedim.

KAPITULLI III

Kompetencat Komunale

Neni 15

Komuna i ushtron kompetencat e veta sipas parimit të subsidiaritetit.

Neni 16

Komuna i ushtron kompetencat vetanake dhe të deleguara në përputhje me ligjin.

Neni 17

Kompetencat vetanake

1. Komunat ushtrojnë kompetencën të plotë dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar dispozitat e përcaktuara në legjislacionin e zbatuar, në fushat që vijnë:
 - 1.1.zhvillimin lokal ekonomik;
 - 1.2.planifikimin urban dhe rural;
 - 1.3.shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
 - 1.4.zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
 - 1.5.mbrojtjen e mjedisit lokal;
 - 1.6.ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhën, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transporti lokal dhe skematë të nxjerrjes lokale;
 - 1.7.përqëndrimi ndaj rasteve emergjente lokale;
 - 1.8.ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagësën e rogate dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
 - 1.9.promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
 - 1.10. ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
 - 1.11. ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, si

- është përkujdesja për të cënueshmit, strehimim familjar, përkujdesjen për fëmijë, përkujdesjen për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagësën e rogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- 1.12. banimin publik;
 - 1.13. shëndetësinë publike;
 - 1.14. licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
 - 1.15. emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
 - 1.16. ofrimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve dhe hapësirës publike;
 - 1.17. turizmit;
 - 1.18. aktivitete kulturore dhe të lira;
 - 1.19. çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk është përcaktuar një autoritet tjetër;

Neni 18

Kompetencat e deleguara

1. Komuna ushtron përgjegjësi të deleguara nga autoritetet qendrore në pajtim me ligjin, për kompetenca vijuesë:
 - 1.1.Shënimet kadastrale;
 - 1.2.regjistrimin civil;
 - 1.3.regjistrimin e votuesve;
 - 1.4.regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
 - 1.5.distribuirimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);
 - 1.6.mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e Komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e durnjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria;
2. Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës mund t'u delegojnë kompetenca shtesë komunave, nëse është e nevojshme, në pajtim me ligjin.
3. Kompetencat e deleguara duhet, në të gjitha rastet, të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

KAPITULLI IV

Financat e Komunës

Neni 19

1. Për mirë të popullatës së komunës, në mënyrë të pavarur rregullohen dhe menaxhohen burimet financiare të cilat rryjnë nga të hyrat vetanake komunale ose të cilat janë ndarë komunës në formë granti të përgjithshëm.

2. Komuna miraton buxhetin dhe financat për financimin e kompetencave të veta.
3. Burimet financiare të një komunë përbëhen nga:
 - a) të hyrat vetanake të Komunës të përcaktuara;
 - b) grantet operative;
 - c) transferet për kompetencat e deleguara;
 - d) grantet e jashtzakonshme; dhe
 - e) të hyrat nga huamarrjet e Komunës.

Neni 20

Burimet financiare të komunës

1. Komuna mbledhë të hyrat vetanake në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore nga:
 - 1.1. tatimi në pronë e paqëndrueshme;
 - 1.2. ngarkesat për shërbime komunale;
 - 1.3. tarifatat për shërbime administrative komunale;
 - 1.4. paluajtshmëritë në pronësi të Komunës;
 - 1.5. tarifatat vjetore për ushtrimin e veprimtarive afariste;
 - 1.6. gjobat në trafik;
 - 1.7. gjobat për shkeljen e rregulloreve të Komunës;
 - 1.8. të hyrat nga sektori i shëndetësisë;
 - 1.9. të hyrat nga sektori i arsimit;
 - 1.10. të hyrat nga donatorët e brendshëm dhe donatorët e jashtëm;
 - 1.11. të hyrat tjera në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore.
2. Të hyrat sipas paragrafit një të këtij neni përcaktohen dhe ndryshohen nga Kuvendi, në harmoni me ligjin.

Neni 21

Administrimi financiar i Komunës

1. Të gjitha çështjet që janë të lidhura me administrimin financiar të Komunës janë përgjegjësi e Kryetarit të Komunës, përshkrimit përgjegjësive dhe kompetencave të Kuvendit.
2. Kryetari i Komunës dhe drejtorët e drejtorive të komunës duhet të mbajnë kontrollin financiar dhe duhet të sigurojnë saktësinë dhe tërësinë e informacioneve financiare dhe sistemeve funksionuese brenda drejtorisë të cilën e menaxhojnë. Ata duhet t'i ofrojnë të gjitha të dhënat dhe informacionet drejtorit të drejtorisë për financa dhe zhvillim ekonomik, si dhe njësisë së auditimit të brendshëm.
3. Drejtori i Drejtorisë për financa dhe zhvillim ekonomik i jep këshilla financiare Kryetarit të komunës dhe komiteteve të Kuvendit, përfshirë edhe vlerësimin e kostos financiare për zbatimin e rregulloreve, vendimeve dhe politikave që shqyrtohen nga organet e Komunës.

Neni 22

Procedurat e prokurimit të Komunës

1. Rregullat, procedurat financiare dhe procedurat e prokurimit të Komunës përkthehen me dispozita ligjore si dhe aktet nënligjore të Ministrisë së financave punës dhe transfereve (në tekstin e mëtejshëm MFPT).

Neni 23

Propozimi i rregulloreve dhe procedurave të tjera

1. Kryetari i Komunës parashtron propozime të rregulloreve, procedurave dhe rregullave të tjera financiare në përputhshmëri me procedurat, rregullat dhe rregulloret e MFPT-së, për të siguruar një administrim efikas financiar brenda Komunës.

Neni 24

Buxheti i Komunës

Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtorisë për Financa dhe Zhvillim Ekonomik dhe drejtorët e drejtorive tjera të Komunës, koordinon procesin e gjithëmbështjellshëm të buxhetit, si dhe procesin e përgatitjes së buxhetit, përmes konsultimeve të brendshme dhe me qytetarë e subjekte të tjera relevante.

Neni 25

1. Buxheti i Komunës duhet të jetë i balancuar, i përgatitur në mënyrë transparente dhe i bazuar në kriteret objektive.
2. Buxheti duhet të përmbajë planin për aktivitete dhe udhëheqje ekonomike brenda vitit fiskal. Duhet të përfshijë të gjitha parashikimet e hyrave, shpenzimet kapitale dhe të përditshme të Komunës. Duhet të ndajë fondet ekzistuese për nevoja e shpenzimeve të Komunës.
3. Organet kompetente të komunës janë të obliguara që me akt të veçantë t'i përcaktojnë procedurat buxhetore, standardet financiare dhe rregullat e furnizimit që i plotësojnë kriteret e parapara me ligj.

Neni 26

4. Përgjegjës për propozimin e buxhetit të Komunës është Kryetari i Komunës, fillimisht në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe pastaj në Kuvend.
5. Viti fiskal i Komunës fillon me një (1) janar dhe përfundon më tridhjetë e një (31) dhjetor të vitit kalendarik. Kryetari i Komunës ia dorëzon buxhetin Komitetit për politikë dhe financa, përkatësisht Kuvendit për miratim sipas Qarkores Buxhetore të MFPT-së të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Neni 27
Miratimi i Buxhetit

Kuvendi e miraton buxhetin e Komunës për një vit fiskal së bashku me projektet prioritare, destinimet, përcaktimin e vlerave për kategoritë ekonomike dhe dinamikën e shpenzimeve të gjithëmbërshme buxhetore të komunës.

Neni 28
Rishikimi i Buxhetit

Në periudhën prej një (1) korrikut dhe më së largu deri më tridhjetë (30) shtator të vitit fiskal, Kuvendi e shqyrton dinamikën e realizimit të mjeteve buxhetore dhe sipas nevojës, e bën ridestinimin e mjeteve përkatëse buxhetore.

Neni 29

Raporti financiar për vitin pararendës fiskal shqyrtohet në kuvend, më së largu deri më tridhjetë e një (31) mars të vitit vijues.

Neni 30

Të dhënat buxhetore dhe raportet financiare janë transparente dhe qytetarët e subjektet e interesuara e kanë të drejtën e qasjes në to.

Neni 31
Buxheti i Ndërmarrjeve Publike

1. Ndërmarrjet komunale të cilat kryejnë shërbime publike, i dorëzojnë Kuvendit buxhetin e tyre për miratim. Buxheti i propozuar duhet të përfshijë strukturën e tarifës së propozuar për kryerjen e shërbimeve dhe duhet të dorëzohet deri më 15 nëntor, para vitit të ardhshëm fiskal.
2. Në rastet kur një ndërmarrje ofron shërbime publike lokale për më shumë se një komunë, komuna bën marrëveshje me komunat gjegjëse për lartësinë e tarifave dhe mbikëqyrjen e përbashkët të veprimtarive të asaj ndërmarrjeje.

Neni 32
Auditimi i Brendshëm

1. Komuna ka obligim ligjor për të bërë auditim të brendshëm, së paku një herë në vit.
2. Komuna ka të drejtë të themelojë një shërbim autonom të auditimit në komunë, apo për të siguruar auditim të brendshëm nga një firmë e akredituar e auditimit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Neni 33

Auditimi i Jashtëm

Niveli qendror bën auditimin e jashtëm të Komunës në baza vjetore, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

KAPITULLI V

Bashkëpunimi ndër komunal

Neni 34

Me qëllim të ushtrimit të kompetencave vetanake dhe të zgjeruara komuna mund të lidhë marrëveshje Bashkëpunimi ndër komunale me një apo më shumë komuna të Republikës së Kosovës në bazë të marrëveshjes për ushtrimin më efikas dhe më efektiv të kompetencave dhe detyrave vetanake dhe të zgjeruara të komunave të përcaktuara me ligj si dhe për realizimin e interesave dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta në fushën e shërbimeve publike komunale dhe të zhvillimit lokal.

Neni 35

1. Nisma për themelimin e bashkëpunimit ndër komunal parashtrohet me shkrim nga:
 - 1.1.Kryetari i Komunës;
 - 1.2.1/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës;
 - 1.3.Së paku 5% e qytetarëve të Komunës me të drejtë vote;
 - 1.4.Qeveria e Republikës së Kosovës, kur themelimi i bashkëpunimit ndër komunal konsiderohet të jetë me interes të veçantë publik dhe lokal.
2. Nisma për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal duhet të përmbajë qëllimin e bashkëpunimit, kompetencat që kanë të bëjnë me bashkëpunimin, komuna e përfshirë në bashkëpunim, formën e bashkëpunimit, përfitimet e pritura, implikimet e mundshme financiare nga bashkëpunimi, si dhe çështje të tjera të rëndësishme mbi themelimin e bashkëpunimit ndër komunal.
3. Kryetari i Komunës brenda tri (3) javëve nga dita e parashtimit të nismës t'ia jep Kuvendit Komunal mendimin e tij me shkrim dhe të arsyetuar lidhur me iniciativën apo propozimin në fjalë, përveç nëse nismën e ka parashtuar vet Kryetari i Komunës.
4. Kuvendi i Komunës e shqyrton nismën së bashku me mendimin e Kryetarit të Komunës dhe merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës mbi nevojën e vendosjes së bashkëpunimit në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 36

5. Kuvendi i Komunës ka për detyrë të mbajë një seancë të hapur për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit lidhur me nismën. Seanca duhet të mbahet Brenda nëntëdhjetë (90)

ditëve nga paraqitja e nismës dhe për këtë duhet t'i informojë palët e interesuara.

6. Nëse Kuvendi i Komunës e miraton nismën për themelimin e bashkëpunimit ndër komunal, atëherë Kuvendi me vendim e autorizon kryetarin e komunës për t'i filluar konsultimet me komunën dhe palët e tjera të interesuara për pjesëmarrjen e tyre në bashkëpunim dhe në bazë të këtyre konsultimeve ta përgatisin propozim marrëveshjen për themelimin e bashkëpunimit ndër komunal.
7. Pas marrjes së autorizimit, kryetari i komunës e njofton komunën gjegjëse për nismën me të cilën kërkohet themelimi i bashkëpunimit ndër komunal.
8. Kuvendi i Komunës, të cilës i dërgohet nisma për themelimin e bashkëpunimit ndër komunal ka për detyrë të merr vendim për fillimin e bisedimeve mbi themelimin e bashkëpunimit të propozuar brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga dita e pranimi të propozimit. Në rast se Kuvendi Komunal e miraton nismën, atëherë ai me vendim e autorizon kryetarin e komunës që të përfaqësojë komunën gjatë bisedimeve për arritjen e marrëveshjes për bashkëpunim ndër komunal.
9. Marrëveshja e bashkëpunimit ndër komunal nënshkruhet nga kryetari i komunës dhe miratohet nga kuvendi i komunës.
10. Marrëveshja e bashkëpunimit ndër komunal bëhet e plotfuqishme pas vlerësimit të ligjshmërisë së saj nga Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale dhe publikimit të marrëveshjes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 37

Partneritetet e përbashkëta publiko private

Në kuadër të bashkëpunimit ndër komunal dhe për nevojat e kryerjes së shërbimeve publike lokale dhe të ofrimit të infrastrukturës publike, komuna mund të hyjnë bashkërisht në forma institucionale ose kontraktore të partneriteteve publiko private në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin përkatës për partneritete publiko private.

Neni 38

Bashkëpunimi komunal ndërkombëtar

1. Në kuadër të kompetencave vetanake dhe të zgjeruara, për nevojat e bashkëpunimit administrative, komuna mund të lidhi marrëveshje bashkëpunimi me komuna dhe institucione të huaja të qeverisjes lokale në pajtim me kushtet, kufizimet dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.
2. Marrëveshjet e lidhura në kuadër të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar mund të jenë vetëm të natyrës administrative dhe teknike.
3. Në kuadër të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, komuna nuk ka të drejtë të heq dorë nga kompetencat e veta të përcaktuara me ligj, t'ia delegojnë një komune ose

autoriteti publik të huaj ushtrimin e kompetencave të veta si dhe t'ia lejojnë komunës ose autoritetit publik të huaj ushtrimin e çfarëdo pushteti ekzekutiv, administrativ, legjislativ në territorin e komunës ose që synon të ketë efekt të tillë.

KAPITULLI VI

Kuvendi i Komunës Neni 39

1. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.
2. Kuvendi ushtron funksionin e pushtetit lokal të përcaktuar me dispozitat ligjore, aktet nënligjore të Nivelit Qendror, me këtë statut dhe rregulloren e punës së Kuvendit.
3. Kuvendi i komunës ka pesëmbëshjetë (15) anëtarë.
4. Mandati i çdo anëtari të Kuvendit të Komunës verifikohet nga komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga Kuvendi i Komunës, para nënshkrimit të mandatit nga secili këshilltar.
5. Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim: “Betohe (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Zubin Potokut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.
6. Anëtarët e Kuvendit të Komunës, të cilët nuk e nënshkruajnë betimin ose mandatin në pajtim me paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni brenda një muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë së qeni anëtarë.
7. Të gjithë anëtarët e Kuvendit, kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta dhe mundësi për të marrë plotësisht pjesë në proceset e Kuvendit. Kuvendi kujdeset që këto të drejta dhe mundësi të përfshihen në rregulloren e punës së Kuvendit.
8. Pusheti dhe detyrat e Komunës ushtrohen nga Kuvendi, organet ekzekutive dhe administrative të Komunës.

Neni 40 Mandati i Anëtarëve të Kuvendit

1. Mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është katër (4) vite.
2. Anëtari i Kuvendit të Komunës pushon të jetë anëtar:
 - 2.1.me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
 - 2.2.nëse nuk nënshkruan betimin, deklaratën solemne brenda një muaji pas zgjedhjes;

- 2.3.nëse ka qenë i dënuar për vepër penale me gjashtë (6) muaj burgim dhe është lëshuar urdhëri për burgim.
 - 2.4.nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhje të Kuvendit, ose në komitetet e tij, përveç nëse ka munguar me arsye të miratuar nga Kuvendit;
 - 2.5.nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur.
 - 2.6.nëse ia paraqet Kryetarit të Komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;
 - 2.7.me vdekjen e anëtarit/es; dhe
 - 2.8.me humbjen e aftësisë për të vepruar.
3. Anëtar i Kuvendit të Komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 41

Konfliktet e interesit

1. Anëtar i Kuvendit të Komunës apo anëtar i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.
2. Çdo anëtar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent. Çdo këshilltar mund të ofrojë informacione për intereset e anëtarit tjetër.
3. Para mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit duhet t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjistër publik të cilin e mbanë shefi i administratës dhe personelit.
4. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.
5. Me Rregulloren të punës përcaktohen masat për përjashtimin e anëtarëve nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, aty ku anëtarët e Kuvendit kanë konflikt të interesit.

Neni 42

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës

1. Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejta dhe mundësi të barabarta të marrin pjesë plotësisht në punimet e Kuvendit. Kuvendi i Komunës siguron që këto të drejta dhe mundësi të parashikohen në rregulloren e tij të punës.
2. Anëtar i kuvendit të komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga kryetari, apo nga zëvendëskryesuesi i komitetit. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e punës.

3. Anëtari i kuvendit të komunës mund të dorëzojë vërejtje me shkrim, të cilat i bashkangjiten procesverbalit.
4. Anëtari i kuvendit të komunës mund t'iu drejtohet të pranishmëve në cilindo komision të kuvendit të komunës anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votojë. Ai apo ajo mund t'i propozojë kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit.
5. Anëtari i kuvendit të komunës mund të kërkojë nga kryetari informacione që janë të nevojshme për punën e tij si këshilltar. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen, ai apo ajo mund ta ngrisë çështjen në kuvendin e komunës.
6. Anëtari i kuvendit të komunës lejohet të mungojë nga vendi i punës për periudha kohore që janë të domosdoshme për kryerjen punëve të kuvendit.
7. Anëtarët e kuvendit të komunës detyrohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e kuvendit, të thirrura në mënyrë të duhur në komisionet ku ata janë anëtarë, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre.

Neni 43

Kompensimi i anëtarëve të Kuvendit

Kuvendi i Komunës, në pajtim me ligjet dhe udhëzimet e nxjerra nga qeveria qendrore, iu ofron kompensim anëtarëve të Kuvendit për punën e tyre në Kuvendin e Komunës, komitete të përhershme, komitetet tjera dhe komisionet e formuara me vendim të kuvendit.

Neni 44

Funksionet e Kuvendit

Kuvendi i komunës funksionon në bazë të ligjit, këtij Statuti dhe akteve të tjera nënligjore.

Neni 45

1. Kuvendi nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:
 - 1.1.statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
 - 1.2.miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
 - 1.3.miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
 - 1.4.planin vjetor të punës së Kuvendit dhe raportin vjetor;
 - 1.5.ngritjen komiteve dhe komisioneve të parapara me dispozita ligjore;
 - 1.6.zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Kuvendit;
 - 1.7.nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
 - 1.8.krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
 - 1.9.emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;

- 1.10. arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- 1.11. marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- 1.12. përgjegjësi të tjera të përcaktuara me dispozita ligjore.

Neni 46

1. Kuvendi mund të delegojë përgjegjësitë për të marrë vendime një komiteti të Kuvendit.
2. Përgjegjësitë e deleguara, Kuvendi mund t'i revokoj në çdo kohë.
3. Një përgjegjësi e deleguar mund të delegohet edhe më tej brenda autoritetit të caktuar me këtë statut.

Neni 47

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

1. Kuvendi i komunës më së largu 30 ditë prej konstituimit zgjedh kryesuesin e kuvendit të komunës nga radhët e anëtarëve të kuvendit.
2. Secili subjekt politik, nismë qytetarësh apo kandidat i pavarur ka të drejtë që nga radhët e anëtarëve të kuvendit të propozoj një anëtar për kryesues të kuvendit të komunës.
3. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës zgjidhet për një mandate të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit.
4. Votimi në të gjitha zgjedhjet për Kryesues të Kuvendit të Komunës është me vota të fshehta.
5. Kuvendi i Komunës me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës formon Komisionin për mbarëvajtjen e votimit i cili përbëhet nga 3-5 anëtarë nga radhët e Kuvendit të Komunës. Komisioni për votim është përgjegjës që t'i numërojë votat dhe t'i komunikoj rezultatet e votimit para anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
6. Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati i propozuar për Kryesues të Kuvendit të Komunës duhet të marrë më shumë se gjysmën e votive të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.
7. Nëse pas votimit të parë asnjëri nga kandidatët e propozuar për Kryesues të Kuvendit të Komunës nuk merr më shumë se gjysmën e votive të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, atëherë dy kandidatët të cilët kanë fituar numrin më të madh të votive shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votive të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në raundin e dytë zgjidhet Kryesues i Kuvendit të Komunës.

8. Nëse edhe pas votimit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar si në paragrafin 5 të këtij neni, atëherë shkohet në votimin e tretë. Në votimin e tretë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës zgjidhet kandidati i cili merr më shumë se gjysmën e votive të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë për propozimin në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.
9. Nëse edhe pas votimit të tretë nuk zgjidhet Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, atëherë i tërë procesi për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës përsëritet.

Neni 48

Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës

1. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë e Financa, kujdeset për funksionimin efikas dhe të rregullt të Kuvendit të Komunës dhe Komisioneve përkatëse të tij dhe përcjellë zbatimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës.
2. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Kryetari i Komunës caktojnë rendin e ditës për mbledhjet e kuvendit.
3. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës njofton komisionin qendror zgjedhor për vendin e lirë të ndonjë anëtarit të kuvendit që pushon të jetë anëtar ashtu siç parashihet me nenin 37 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.
4. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës nënshkruan të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës.
5. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës pas nënshkrimit të akteve të miratuara nga kuvendi një kopje të aktit të nënshkruar ia dorëzon Kryetarit të Komunës.
6. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për ushtrimin e këtyre kompetencave i nevojiten resurse njerëzore dhe material, të cilat sigurohen nga Ekzekutivi i Komunës.
7. Rregullorja e punës së Kuvendit përcakton se kush e thërret dhe e kryeson mbledhjen e Kuvendit të Komunës nëse posti i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës mbetet i lirë.

Neni 49

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

1. Kuvendi i Komunës mbanë:
 - 1.1.Mbledhje inauguruese;
 - 1.2.Mbledhje të rregullta;
 - 1.3.Mbledhje të jashtëzakonshme;
 - 1.4.Mbledhje urgjente; dhe
 - 1.5.Mbledhje solemne.

2. Të gjitha mbledhjet duhet të thirren dhe mbahen në pajtueshmëri me Rregulloren e punës së Kuvendit.
3. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.
4. Kuvendi mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet edhe me Rregulloren e Punës.

Neni 50

Mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës

1. Mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës e thërret Kryetari i Komunës, (nëse është zgjedhur) Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga KQZ-ja.
2. Ftesa për mbledhje inauguruese dërgohet shtatë (7) ditë punë për mbajtjen e mbledhjeve Kuvendit.
3. Në raste të veçanta ftesa mund të dërgohet tre (3) ditë pune për mbajtjen e mbledhjes.
4. Nëse Kryetari i Komunës nuk e thërret mbledhjen sipas paragrafit 1 të këtij neni mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga anaëtar i më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur Kryetari është dashur të thirr mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës.
5. Nëse anëtar i më i vjetër i Kuvendit nuk thërret mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës, mbledhja thirret me iniciativën shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës.
6. Kryesimin e mbledhjes inauguruese dhe të gjitha mbledhjeve tjera të Kuvendit deri në zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës e bënë anëtar i më i vjetër i Kuvendit të Komunës.
7. Në mbledhjen inauguruese në rend dite është dhënia e betimit të anëtarëve të Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës, dhe zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
8. Dhënia e betimit të anëtarëve të Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës është akt solemn dhe duhet të nënshkruhet.

Neni 51

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës

1. Kryesuesi i Kuvendit i thërret dhe i kryeson mbledhjet e rregullta të Kuvendit.
2. Në mbledhjen e parë të çdo viti vijues Kuvendi miraton orarin (cakton datat), në të cilat planifikohet të mbahen mbledhjet e rregullta gjatë vitit përkatës.

3. Kuvendi mund të mblidhet me ftesë të kryesuesit të Kuvendit edhe jashtë orarit të paraparë për mbajtjen e mbledhjeve.
4. Kryesuesi apo anëtar i më i vjetër i Kuvendit i cili kryeson mbledhjen duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në gjithë veprimet e zhvilluara në kuvend.
5. Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:
 - 5.1. data e mbajtjes së mbledhjes;
 - 5.2. koha e mbajtjes së mbledhjes;
 - 5.3. vendi i mbajtjes së mbledhjes;
 - 5.4. rendi i ditës për mbledhje;
 - 5.5. materialet e mbledhjes; dhe
 - 5.6. të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Rregullore të Punës.
6. Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin mbi gjuhët, i njëjti njoftim duhet t'i shpallet publikut.
7. Njoftimi nga paragrafët 5 dhe 6 të këtij neni duhet gjithashtu t'i dërgohet ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.

Neni 52

Mbledhjet e jashtëzakonshme

1. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës caktohen me kërkesën e bërë me shkrim nga më së paku, 1/3 (një e treta) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, apo me kërkesë të Kryetarit të Komunës.
2. Kryesuesi i Kuvendit është i obliguar ta thërras mbledhjen me kërkesën e bërë me shkrim nga më së paku, 1/3 (një e treta) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, apo me kërkesë të Kryetarit të Komunës.
3. E drejta për të thirrur një takim të jashtëzakonshëm gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.
4. Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.
5. Takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit të Komunës nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe publiku nuk janë njoftuar, siç kërkohet me rregulloret e punës, së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit.

6. Procedurat e njëjta që kërkohen për njoftimin dhe çështjet e tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme gjithashtu.
7. Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

Neni 53

Mbledhjet urgjente

1. Mbledhjen urgjente të Kuvendit e thërret kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.
2. Mbledhja urgjente e Kuvendit të Kuvendit thirret në rastet e fatkeqësive natyrore apo rrethanave tjera urgjente në Komunë.
3. Procedurat e thirrjes së mbledhjeve urgjente nuk zbatohen si në rastet e thirrjes së mbledhjeve tjera.

Neni 54

Mbledhjet solemne

1. Mbledhjen solemne të Kuvendit e thërret Kryesuesi i Kuvendit ose Kryetari i Komunës.
2. Mbledhja solemne e Kuvendit thirret në rastet e veçanta, festa shtetërore, festat e komunës, apo solemnitetet tjera në komunë.
3. Mbledhja solemne thirret së paku 1 (një) ditë para mbajtjes së mbledhjes.

Neni 55

Pjesëmarrja e publikut me mbledhje dhe transparenca

1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve dhe të gjitha komisioneve të tij janë të hapura për publikun.
2. Anëtarëve të Kuvendit u lejohet pjesëmarrja në takime të Kuvendit të Komunës, ashtu siç është paraparë në Rregulloren e punës.
3. Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës ose Komiteti përkatës siguron materialet e nevojshme si dhe hapësirën për pjesëmarrjen e publikut dhe përfaqësuesit e mediave të shkruara dhe elektronike, në vendin ku mbahet mbledhja.
4. Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës ose Komiteti përkatës, nëpërmes njësisë, zyrtarit për informim, njofton publikun së paku shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta dhe tre (3) ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme, përmes:
 - 4.1. shpalljeve publike në tabelat informuese brenda territorit të Komunës;

- 4.2. ueb faqes zyrtare të Komunës dhe rrjeteve sociale.
5. Njoftimi publik sipas paragrafit 3 të këtij neni përmban:
- 5.1. datën, kohën, vendin e mbajtjes së mbledhjes;
 - 5.2. rendin e ditës;
 - 5.3. materialet e mbledhjes; dhe
 - 5.4. të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut dhe Rregulloren e punës.
6. Komuna përmes ueb faqes zyrtare transmeton mbledhjet e Kuvendeve të Komunës, duke përdorur pajisjet e nevojshme për transmetim.
7. Publikimi në ueb faqen zyrtare të Komunës i akteve normative të Komunës me karakter të përgjithshëm është i obligueshëm.
8. Të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës që ndikojnë drejtpërdrejt në interesat e qytetarëve pas nënshkrimit publikohen në ueb faqen zyrtare të Komunës.
9. Aktet normative dhe vendimet e organeve të Komunës dërgohen në njësinë përgjegjëse për publikim në ueb faqen zyrtare të Komunës në formën elektronike, në gjuhët zyrtare dhe në formatin e përcaktuar nga njësia/zyrtari përgjegjës/e për publikim të aktit normative dhe vendimet e organeve të Komunës.
10. Kuvendi i Komunës, apo komiteti, me votën e shumicës, mund të vendosë për përjashtimin e publikut nga i tërë takimi, apo nga një pjesë e tij, në rastet kur:
- 10.1. mendohet se mbajtja e një takimi të hapur mund të shpie deri te një çrregullim publik apo dhunë;
 - 10.2. takimi i hapur kërcënon të zbulojë informacione (dhe dokumente), të cilat janë të klasifikuara si të besueshme sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare;
 - 10.3. kërcënon të zbulojë informacione të ndjeshme personale apo komerciale;
 - 10.4. informacione lidhur me procedurat gjyqësore të tanishme apo të ardhshme; dhe
 - 10.5. në rastet e tilla, Kuvendi i Komunës njofton publikun për vendimin e marrë.
11. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës ose të Komiteteve mund të jenë të mbyllura, pjesërisht ose tërësisht, vetëm për shkaqet e parashikuara me legjislacionin në fuqi.
12. Kuvendi i Komunës ose Komitetët përkatëse me vendim shpallin mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.
13. Çdo person mund të ketë qasje në dokumentet e Komunës në pajtim me ligjin në fuqi mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

Neni 56

Kuorumi dhe vendimmarrja

1. Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit komiteteve dhe komisioneve të tij përbëhet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, apo komitetit (50 %+1).

2. Kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi të marrë.
3. Kuvendi, komitetet dhe komisionet marrin vendime me votim të hapur, përveç nëse kërkohet ndryshe me ligj, këtë statut dhe me rregulloren e punës të Kuvendit.
4. Në të gjitha takimet e Kuvendit të Komunës dhe komitetet e tij, çdo anëtar, përfshirë edhe kryesuesin, ka nga një votë, por kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.
5. Nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht me ligj dhe këtë Statut, vendimet e Kuvendit të Komunës aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë.
6. Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorunit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

Neni 57

Rendi i ditës

1. Rendi i ditës për takimin e Kuvendit të Komunës caktohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në marrëveshje me Kryetarin e Komunës.
2. Anëtar i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë shtimin e një pikë para miratimit të rendit të ditës gjatë seancës së rregullt të Kuvendit të Komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.
3. Kërkesa e tillë mund të miratohet apo refuzohet me votën e shumicës.
4. Rendi i ditës nuk mund të ndryshohet në rastet mbajtjes së mbledhjes të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.

Neni 58

Procesverbali

1. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe komiteteve mbahet procesverbali. Procesverbali përmban emrat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në mbledhje dhe personave tjerë të pranishëm; rendin e ditës; esencën e diskutimeve; rezultatin numerik të votimit; çfarëdo vote që ka dhënë çdo njeri nga anëtarët e Kuvendit, propozimet e miratuara apo të refuzuara; nëse kërkohet të thirret emri i çdo anëtar, në procesverbal të shënohet si ka votuar.
2. Procesverbalet miratohen në mbledhjen e ardhshme dhe nënshkruhen nga kryesuesi i mbledhjes.
3. Procesverbalin e mban një shërbyes civil komunal, i caktuar nga sekretaria e Kuvendit.

4. Procesverbali ju shpërndahet të gjithë anëtarëve të Kuvendit dhe mund ta marrin edhe pjesëmarrësit tjerë në mbledhje.

Neni 59

Shpërndarja e Kuvendit jo funksionues të Komunës

1. Kuvendi i Komunës konsiderohet jo funksionuese nëse:
 - 1.1.nuk e zgjedh kryesuesin, tridhjetë (30) ditë pas themelimit;
 - 1.2.nuk miraton buxhetin sipas afatit të paraparë me ligjin përkatës; dhe
 - 1.3.nuk mban mbledhje për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj;
2. Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale e njofton Qeverinë e Republikës së Kosovës për mosfunksionimin e Komunës. Qeveria mund ta shpërndajë Kuvendin e Komunës jo funksionues.
3. Zgjedhjet e reja për Kuvendin e Komunës mbahen në pajtim me ligjin për zgjedhjet lokale.

Neni 60

Komitetet e Kuvendit

1. Kuvendi themelon Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitete të përhershme.
2. Kuvendi i Komunës themelon komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësi të tyre.
3. Nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, komitetet reflektojnë përbërjen e Kuvendit të Komunës.
4. Kuvendi i Komunës gjatë themelimit të komiteteve duhet të siguroj përfaqësim të barabartë gjinor.

Neni 61

Mbledhjet e komiteteve të përhershme

1. Mbledhjet e komiteteve të përhershme thirren nga kryesuesi i komitetit, si dhe me 1/3 e anëtarëve të komitetit.
2. Komitetet e përhershme mbajnë mbledhje të rregullta dhe urgjente varësisht nga nevoja.
3. Ftesa për mbledhje të rregullta përmban:
 - 3.1.Rendin e ditës;
 - 3.2.Kohën dhe vendin e mbajtjes se mbledhjes; dhe

3.3. Materialet për pikat që shqyrtohen në mbledhje.

4. Ftesa për mbledhje duhet tu dërgohet anëtarëve të komitetit 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.
5. Mbledhjet urgjente thirren nga kryesuesi dhe 1/3 e anëtarëve të komitetit për çështjet konkrete që duhet trajtua me urgjencë.

Neni 62

Rekomandimet dhe raportimi i komiteve të përhershme

1. Rekomandimet në komitetet e përhershme merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
2. Në secilën mbledhje të komitetit mbahet procesverbal i cili miratohet në mbledhjen e radhës.
3. Komitetet e përhershme i dorëzojnë Kuvendit të Komunës raportin vjetor të punës për shqyrtim dhe miratim.

Neni 63

Mandati i anëtarëve të komiteve të përhershme

1. Mandati i anëtarëve të komiteve të përhershme është 4 vjeçar, dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kuvendit të komunës.
2. Anëtarët e komiteve të përhershme pushojnë të jenë anëtarë:
 - 2.1. Me rastin e përfundimit të mandatit;
 - 2.2. Me dorëheqjen e anëtarët;
 - 2.3. Në rast të vdekjes;
 - 2.4. Nëse nuk merr pjesë në mbledhje 3 (tri) mbledhje radhazi pa arsye; dhe
 - 2.5. Kur anëtari kalon në ndonjë etnitet tjetër politik, në këtë rast anëtari zëvendësohet nga anëtari nga radhët e të njëjtit subjektit politik të cilit i ka takuar anëtari me rastin e themelimit të komitetit.

Neni 64

Komiteti për Politikë dhe Financa

1. Kuvendi i Komunës merr vendim për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet prej jo më shumë se 5 (pesë) anëtarë.
3. Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë përfaqësimin e entitete politike në Kuvendin e Komunës.

4. Në rast se në përbërjen e Kuvendit janë të përfaqësuara më shumë etnitete politike me çka e bëjnë të pamundur përfshirjen e të gjitha etnitetëve atëherë përfaqësimi do të bëhet në bazë të përqindjes së përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.
5. Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, në rastet kur është caktuar mbledhja dhe mungon kryesuesi mbledhja kryesohet nga anëtari më i vjetër i komitetit.
6. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e:
 - 6.1.Të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare;
 - 6.2.Planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik;
 - 6.3.Komizën vjetore buxhetore dhe afatmesme;
 - 6.4.Planin vjetor të prokurimit;
 - 6.5.Rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat;
 - 6.6.Planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm;
 - 6.7.Buxhetin vjetor dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal;
 - 6.8.Për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvend; dhe
 - 6.9.Monitorimin e bashkëpunimit, ndër komunal, me nivelin qendror dhe me jashtë.
7. Anëtarët e Komitetit për politikë dhe financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtar të komiteteve tjera.
8. Kuvendi mund t'i delegojë edhe përgjegjësi tjera nga fushëveprimi i tij Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 65

Komiteti për Komunitete

1. Komiteti për Komunitete përbëhet nga anëtarët e Kuvendit dhe përfaqësuesit e komuniteteve.
2. Komiteti për Komunitete përfshin anëtarët e komuniteteve jo shumicë të përfaqësuar në Kuvend dhe jashtë tij.
3. Komiteti për Komunitete përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve.
4. Zgjedhja e anëtarëve nga radhët e komuniteteve bëhet me propozimin e kandidatëve të ofruar nga komunitetet, ndërsa miratimi bëhet nga Kuvendi.
5. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit bëhet me shumicë votash të anëtarëve të komitetit.
6. Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për:
 - 6.1.Promovimin dhe afirmimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe shqyrton pdo shkelje që bëhet në këtë drejtim dhe bën rekomandime për Kuvendin

- e Komunës.
- 6.2.Shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.
- 6.3.Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor; dhe
- 6.4.Për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda Komunës.

Neni 66

Komitetet tjera

1. Kuvendi i komunës për kryerjen e përgjegjësiave me vendim themelon edhe komitetet:
 - 1.1.Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
 - 1.2.Komitetin për Arsim dhe Kulturë;
 - 1.3.Komitetin për Zhvillim Ekonomik;
 - 1.4.Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit; dhe
 - 1.5.Komitetin për Barazi Gjinore.
2. Komitetet e cekura në pikën një të këtij neni themelohen në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, me kusht që shumica e anëtarëve duhet të jenë anëtar të Kuvendit të Komunës.
3. Anëtarët e jashtëm të komitetit nuk kanë të drejtë vote në komitet.
4. Komitetet duhet të reflektojnë përbërjen e Kuvendit të Komunës.
5. Anëtarët e komiteteve për punën e tyre në komitet kompensohen nga buxheti i Komunës. Shuma e kompensimit është në proporcion më shumë e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.
6. Anëtarët e komiteteve nuk mund të paguhen më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

Neni 67

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale përcjell kujdesin shëndetësor primar dhe në kuadër të bashkëpunimit ndër komunal kujdesin shëndetësor sekondar, për stabilimentet që lidhen me ujin e pijes, kanalizimin, trajtimin e ujërave, grumbullimin dhe hedhjen e mbeturinave, si dhe përkrahjen për shërbime sociale dhe banim.
2. Këshillon Kuvendin në çështjet që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe mirëqenien sociale. Mbikëqyrë punën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Drejtorisë për Integritet Evropiane dhe Mirëqenie Sociale në çështjet që lidhen me politikat shëndetësore e sociale në komunë, dhe jep rekomandime në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 68
Komiteti për Arsim, Kulturë dhe Rini

1. Përcjellë fushat që kanë të bëjnë me edukimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe kopshtet e fëmijëve, themelimin dhe funksionalizimin e institucioneve mësimore, punësimin e stafit mësimdhënës, themelimin dhe funksionalizimin e objekteve në fushën e sportit dhe kulturës, si dhe organizimin e ngjarjeve kulturore dhe sportive.
2. Ky komitet, monitoron punën e Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe jep rekomandime sipas ligjeve në fuqi.

Neni 69
Komiteti për Financa, Buxhet dhe Zhvillim Ekonomik

1. Përcjell fushat që kanë të bëjnë me përkrahjen e zhvillimit ekonomik të Komunës, përfshirë këtu organizimin e panairove të tregtisë dhe tregjeve, tërheqjen e bizneseve dhe turizmit si dhe për bashkëpunimin e bizneseve në nivelin lokal.
2. Ky komitet mbikëqyrë punën e Drejtorisë së Financave dhe Zhvillimit Ekonomik dhe jep rekomandime sipas ligjeve në fuqi.

Neni 70
Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Gjeodezi dhe Mbrojtje të Mjedisit

1. Përcjell planet hapësinore të përgjithshme e specifike për zonat urbane dhe rurale, përfshirë këtu çështjet që lidhen me banimin, ndërtesat publike, turizmin, mbrojtjen e mjedisit, zonat për shfrytëzim publik sikur që janë parqet, fushat e gjelbërta dhe hapësirat rekreative, sheshet e lojërave si dhe transporti publik.
2. Ky komitet ndihmon Kuvendin në hartimin dhe miratimin e rregulloreve për këto fusha: lëvizjet e trafikut, parkingjet, ndërtimet, lëshimi i lejeve ndërtimore, standardet e mirëmbajtjes, rrugët komunale dhe vendkalimet për këmbësor, identifikimin e veçorive të interesit natyror, historik e mjedisor, përfshirë këtu mbrojtjen e tyre.
3. Ky komitet monitoron punën e sektorëve të Urbanizmit, Kadastrit, Gjeodezisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit në çështjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e tokës dhe politikat mjedisore në komunë, si dhe jep rekomandimin në përputhje me ligjet në fuqi.
4. Për themelimin e secilit komitet duhet të votohet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm të Kuvendit.

Neni 71
Komitetet Konsultative

1. Komitetet Konsultative themelohen nga Kuvendi pas propozimit të marr nga Kryetari i

Komunës, komitetet e përhershme në komunë dhe nga grupi i qytetarëve.

2. Anëtarësimi në komitete konsultative bëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilët njëherit duhet të jenë njohës të fushave përkatëse. Njohës i asaj fushe apo anëtar organizatës e cila merret me atë fushë veprimtari.
3. Kuvendi shpall konkurs publik për anëtarësimin në komitetin përkatës duke përcaktuar kriteret për konkurrim/anëtarësim.
4. Kandidati për anëtar duhet të jetë banor i Komunës.
5. Përfaqësimi gjinor në Komitetet Konsultative duhet të jetë në kuotën e 50%, duke përfshirë pjesëtarët e popullsisë jo shumicë, në proporcion të përfaqësimit të tyre në komunë.
6. Kuvendi ngritë panelin për intervistim të kandidatëve i cili duhet të ketë në përbërje anëtarë të Kuvendit dhe shoqërisë civile, i cili do t'i propozojë Kuvendit të Komunës listën me anëtarët për Komitetet Konsultative.

Neni 72 **Komisionet ad hoc**

1. Kuvendi për shqyrtimin e çështjeve të caktuara mund të formoi Komisione ad hoc dhe grupe punuese.
2. Mandati i Komisioneve ad hoc dhe grupeve punuese caktohet me vendim të Kuvendit dhe pushon pas zgjidhjes së çështjes.

Neni 73

Kuvendi në kuadër të kompetencave miraton Rregulloren për përgjegjësitë dhe fushë veprimtarinë e komiteve të përhershme, komiteve tjera, komisioneve dhe grupeve punuese.

KAPITULLI VII **EKZEKUTIVI I KOMUNËS**

Neni 74 **Zgjedhja e Kryetarit të Komunës**

1. Kryetari i Komunës zgjidhet me zgjedhje të drejtpërdrejta në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.
2. Kryetari i Komunës zgjidhet për një periudhë katër vjeçare.
3. Mandati i Kryetarit të Komunës përfundon:
 - 3.1.kur ta kryejë mandatin e tij;

- 3.2.nëse vdes;
- 3.3.nëse jep dorëheqje;
- 3.4.nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër;
- 3.5.nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj pa arsye;
- 3.6.nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me këtë ligj;
- 3.7.në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon Kryetarin nga cilësia juridike; dhe
- 3.8.në rast të dënimit për veprë penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

Neni 75 Betimi

1. Me rastin e zgjedhjes, Kryetari e jep betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
2. Teksti i betimit është si në vijim: “Beto hem (ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat e mia dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Zubin Potokut me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë.”
3. Dhënia e betimit është akt solemn dhe duhet të nënshkruhet.
4. Mungesa e kuorumit nuk ndikon në dhënien e betimit nga Kryetari i Komunës.
5. Nëse Kryetari dështon ta japë betimin brenda një (1) muaji nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve e humbet mandatin.

Neni 76 Përgjegjësitë e Kryetarit

1. Kryetari i Komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:
 - 1.1.Përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;
 - 1.2.Udhëheq ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyr administrimin financiar të Komunës;
 - 1.3.Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
 - 1.4.Ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës;
 - 1.5.Nxjerr vendime dhe Urdhëresa;
 - 1.6.Emëron apo shkarkon drejtorët e drejtorive;
 - 1.7.Emëron dhe shkarkon anëtarët e tij të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
 - 1.8.Organizon punën dhe drejton politikën e Komunës;
 - 1.9.Thërret dhe kryeson mbledhjet e Bordit të Drejtorëve dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së tij;
 - 1.10. Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;
 - 1.11. Propozon miratimin e buxhetit të Komunës pas mbajtjes së konsultimeve të

- nevojshme në Kuvendin e Komunës, dhe është përgjegjës i drejtpërdrejtë për zbatimin e tij në pajtim me procedurat ligjore;
- 1.12. Propozon projekte për zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese dhe projekte tjera sipas nevojës;
 - 1.13. raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës;
 - 1.14. Mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim apo interesin e komuniteteve;
 - 1.15. Konsulton nënkryetarin për komunitete për pështjet që kanë të bëjnë me komunitetin jo shumicë (kur ka nënkryetar të emëruar);
 - 1.16. Kujdeset për zbatimin e legjislacionit që ka të bëjë me përgjegjësitë e Komunës;
 - 1.17. Propozon Kuvendit të Komunës miratimin e rregullores për organizimin e brendshëm të Komunës;
 - 1.18. Propozon Kuvendit të Komunës konstituimin, organizimin dhe mënyrën e punës së organeve komunale, si dhe krijimin e institucioneve dhe ndërmarrjeve;
 - 1.19. Në bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit të Komunës e cakton rendin e ditës për mbledhjen e Kuvendit, dhe merr pjesë në mbledhje të Kuvendit dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe në mbledhjet e komiteteve dhe komisioneve tjera;
 - 1.20. Kujdeset për zbatimin e Statutit dhe Rregullores së Punës;
 - 1.21. Ndan mirënjohje dhe falënderime në përputhje me rregulloren komunale;
 - 1.22. Shpall, rekruton dhe largon Udhëheqësin e Personelit, në pajtim me legjislacionin në fuqi; dhe
 - 1.23. Kujdeset për transparencën e Komunës.

Neni 77

Konfliktet e interesit

1. Menjëherë pas zgjedhjes së tij, Kryetari i komunës ndërpret çdo kontratë apo lidhje që ka dhe e cila mund ta vë në pikëpyetje aftësinë e tij për kryerjen e përgjegjësiave në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.
2. Kryetari i Komunës përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse dhe administrative që kanë të bëjnë me ndonjë çështje, në të cilën ai, apo ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal apo financiar.
3. Nga Kryetari i Komunës kërkohet t'i paraqesë konfliktet e interesit sapo të paraqiten ato.
4. Kryetari i Komunës mundet vullnetarisht ta përjashtojë veten nga vendimmarrja dhe procedurat administrative, nëse konsideron që mund të ketë konflikt të interesit. Kryetari i Komunës shënon çdo ndryshim në gjendjen financiare menjëherë pasi që ai të paraqitet.

5. Rastet e tjera të cilat trajtohen si konflikt interesi dhe masat që duhet të ndërmerren për të përjashtuar Kryetarin nga procedurat e vendimmarrjes dhe administrative në rastet kur ka konflikt të interesit janë të rregulluara me aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

Neni 78

Nënkryetari i Komunës

1. Kryetari i Komunës emëron një nënkryetar.
2. Nënkryetari emërohet nga Kryetari jo më larg se 30 ditë nga dhënia e betimit nga Kryetari, për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari.
3. Nënkryetari i Komunës duhet së paku 3 vite të jetë banor i Komunës.
4. Me kërkesë të Kryetarit, nënkryetari i ndihmon Kryetarin në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.
5. Në rast të mungesës së Kryetarit, nënkryetari i Komunës është i obliguar ta zëvendësoj dhe të veproi në emër të Kryetarit të Komunës.
6. Kur posti i nënkryetarit mbetet i lirë, Kryetari emëron nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.
7. Neni 77 i këtij statuti për konfliktet e interesit të Kryetarit zbatohet mutatis mutandis për Nënkryetarin.
8. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Komunës detyrën e Kryetarit deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri e ushtron Nënkryetari.

Neni 79

Nënkryetari i Komunës për Komunitete

1. Komuna do të ketë një nënkryetar për komunitete vetëm nëse të paktën 10% e qytetarëve në komunë i përkasin komuniteteve jo shumicë.
2. Nënkryetari për komunitete do të emërohet për mandat të njëjtë si Kryetari.
3. Emërimi dhe shkarkimi i Nënkryetarit për Komunitete propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë.
4. Nënkryetari për komunitete do t'i ndihmojë Kryetarit dhe do të ofrojë këshilla dhe udhëzime për Kryetarin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë.

5. Kur posti i nënkryetarit për komunitete mbetet i lirë, Kryetari propozon nënkryetarin e ri, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas paraqitjes së postit të lirë sipas procedurave të paragrafit 3 (tre) të këtij neni.
6. Neni 77 për konfliktet e interesit të Kryetarit zbatohet mutatis mutandis për nënkryetarin për komunitete.

Neni 80

Për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara me ligj dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Kuvendi, Kryetari ndihmohet nga nënkryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive dhe administrata komunale.

Neni 81

Shkarkimi i Kryetarit të Komunës

1. Kryetari mund të suspendohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve, nëse ka cenuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.
2. Nëse konsiderohet se janë plotësuar kushtet për suspendimin e Kryetarit nga detyra, ministria përgjegjëse për pushtet lokal do t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës suspendimin e tij.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës brenda 30 (tridhjetë) ditëve, mund të suspendojë me vendim Kryetarin dhe t'i dorëzojë lëndën gjykatës kushtetuese.
4. Nëse Gjykata kushtetuese e përkrah vendimin, Qeveria mund ta shkarkojë Kryetarin nga detyra.

Neni 82

Largimi i Kryetarit

1. Qytetarët e Komunës mund të ndërmarrin iniciativë për largimin e Kryetarit të Komunës.
2. Kërkesa e tillë duhet të nënshkruhet nga njëzetë 20% e votuesve të regjistruar dhe i dorëzohet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, i cili e paraqet çështjen në institucionin përkatës për administrimin e votimit.
3. Nëse shumica e votuesve të regjistruar votojnë për largimin e Kryetarit, zgjedhjet e reja për Kryetar duhet të bëhen në pajtim me legjislacionin në fuqi për zgjedhjet.

Neni 83

Drejtorët e Drejtorive të Komunës

1. Ekzekutivi-Administrata e Komunës organizohet në drejtori.

2. Kuvendi i Komunës me rregullore të veçantë përcakton organizimin e brendshëm të Administratës Komunale, kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës, si dhe numrin e drejtorive.
3. Çdo drejtori menaxhohet nga drejtori, i cili emërohet nga Kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari.
4. Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtorinë përkatëse, në përputhje me dispozitat ligjore, aktet nënligjore, dispozitat e këtij Statuti, rregulloret e Komunës, si dhe udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit.
5. Drejtorët i raportojnë rregullisht Kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë e tyre dhe i ofrojnë atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.
6. Kryetari i Komunës në afat prej gjashtë (6) muajsh prej miratimit të këtij Statuti i propozon Kuvendit të Komunës miratimin e Rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorive dhe sektorëve tjerë të Administratës Komunale.

Neni 84

Konflikti i Interesit për Drejtorët e Drejtorive të Komunës

1. Drejtorët përjashtohen nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjesh për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij ka ndonjë interes personal ose financiar.
2. Nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash menjëherë pasi shfaqen.
3. Rregullorja e punës përfshinë masat të cilat merren për të përjashtuar Drejtorët nga vendimmarrja dhe procedurat administrative ku ata kanë ndeshje interesash.

Neni 85

Zyrtarët e Komunës

1. Stafi i punës në komunë përbëhet nga Shërbyesit Civil dhe zyrtarët e tjerë publik, paga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, dhe të cilët janë të punësuar dhe udhëhiqen në bazë të legjislacionit në fuqi.
2. Punësimi do të bëhet në bazë të kushteve të parapara ligjore duke u përzgjedhur kandidatët me kualifikime dhe përvojë të duhur.
3. Shërbyesit Civil dhe Zyrtarët e tjerë Publik ju mundësohet ndjekja e trajnimeve të ndryshme të cilët janë të nevojshme për ngritje në karrierë (gradim).

Neni 86

1. Administrata komunale ka Udhëheqësin e personelit, i cili rekrutohet nga Kryetari i Komunës, në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore në Republikën e Kosovës.
2. Procedurat e punësimit në komunë do të mbikëqyren dhe do të udhëhiqen nga Udhëheqësi i personelit, duke ju ofruar pjesëmarrje të drejtë në procedurë të gjithëve në bazë të kriterëve
3. Punësimi në institucion, si tërësi, duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara dhe duhet të sigurojë bilancin në barazinë gjinore.
4. Punësimi i zyrtarëve në komunë bëhet përmes konkursit publik, në pajtim me ligjet e aplikueshme.
5. Të gjithë të punësuarit duhet t'i zbatojnë urdhrat e eprorëve, përveç rasteve kur urdhrat e tyre janë në kundërshtim me legjislacionin.
6. Zyrtarët janë të obliguar që të paraqesin konfliktet e interesit në rast se paraqiten gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi të tyre.

Neni 87

Raporti Vjetor

1. Kryetari i Komunës paraqet raportin vjetor, pas përfundimit të çdo viti fiskal. Raporti i prezantohet Kuvendit për miratim deri me 31 (tridhjetë e një) mars të vitit vijues.
2. Raporti duhet të përmbaj:
 - 2.1. Të hyrat dhe të dalat e planifikuara;
 - 2.2. Realizimet, synimet e planifikuara me buxhet dhe shkallët e realizimit të tyre;
 - 2.3. Mënyrën dhe lartësinë e financimit të aktivitetit të caktuar;
 - 2.4. Gjendjen financiare të Komunës në fund të vitit fiskal;
 - 2.5. Raportin e kontrollit financiar;
 - 2.6. Përkrahjen e dhënë organizatave jo fitimprurëse; dhe
 - 2.7. Marrëveshjet e arritura me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe të dhënat tjera të parapara me ligj dhe me akte tjera nga lëmi i financave.

Neni 88

1. Në mënyrë që të përmbushen përgjegjësit për raportim të Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Politikë e Financa, duhet të ndërmerren veprimet, si në vijim:
 - 1.1. Në buxhetin vjetor duhet të përfshihen objektivat e Komunës në lidhje me aktivitetet, për të cilat është përgjegjëse komuna;
 - 1.2. Objektivat duhet të mbahen nën mbikëqyrje të vazhdueshme;
 - 1.3. Të ndërtohen mekanizmat përmes të cilave monitorohet arritja e objektivave; dhe

- 1.4. Të identifikohen nevojat aktuale dhe ato të ardhshme dhe të përcaktohen mjetet përmes së cilave sigurohet përmbushja e tyre.

KAPITULLI VIII

Konsultimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes

Neni 89

Kërkesat për informim, iniciativat qytetare dhe petitionet

1. Çdo subjekt fizik ose juridik ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për realizimin e ndonjë të drejte, iniciativë qytetare dhe petition, për çështje që janë përgjegjëse organet e komunës.
2. Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga kuvendi apo me votën e qytetarëve, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Çdo person apo organizatë me interes në komunë ka të drejtën e prezantimit të petitionit në kuvendin e komunës për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Kuvendi i komunës shqyrton petitionin në pajtim me statutin dhe rregulloren e punës.
4. Subjektet e përmendura më lart mund t'i drejtojnë petition Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij në mënyrë të pakufizuar, e që kanë të bëjnë me:
 - 4.1. rregullimin e qytetit;
 - 4.2. mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së komunës/qytetit;
 - 4.3. urbanizimin e qytetit dhe të fshatit;
 - 4.4. mirëmbajtjen e mjedisit jetësor;
 - 4.5. zbatimin e vetëkontrollit; dhe
 - 4.6. çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.
5. Kërkesat, iniciativat qytetare dhe petitionet shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh siç është e përcaktuar në nenin 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.
6. Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës Kryetari i Komunës ose shërbimi përkatës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose petitionit.
7. Në raste kur kërkesa për realizimin e ndonjë të drejte, initiative qytetare ose petitioni, lidhen me çështje për të cilat komuna nuk është drejtpërdrejt kompetente, Kryetari i Komunës ose shërbimi përkatës, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose petitionit se është jo kompetente, si dhe procedon atë tek organet kompetente duke njoftuar edhe parashtruesin e kërkesës.

Neni 90

Takimet me qytetarë

1. Çdo vit komuna mban së paku dy takime publike me qytetarë për çështje të interesit të përgjithshëm.
2. Njëri nga takimet publike duhet të mbahet në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit, ndërkah takimi tjetër mbahet në gjashtë (6) mujorin e dytë të vitit.
3. Në takimet publike është e obliguar të marrin pjesë zyrtarët më të lartë të organeve të komunës si: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Drejtorët e Drejtorive, Kryetarët e Komiteteve dhe Zyrtarët kompetentë për çështje në diskutim publik.
4. Vendi, data dhe koha kur do të mbahen takimet me qytetarë, shpallen në mediat elektronike dhe të shkruara, në tabelën e shpalljeve në ndërtesës së Komunës dhe në vendet më frekuentuese në qytet, në fshatra dhe në lagje urbane, në ueb faqen zyrtare të Komunës si dhe në rrjetet sociale, dy (2) javë para mbajtjes së takimit.
5. Shpalljen publike e bën Zyra për marrëdhënie me publikun.
6. Takimet publike i udhëheq dhe i kryeson Kryetari i Komunës, apo përfaqësuesi i tij.
7. Kryetari është i autorizuar ta caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevojë, ka të drejtë t'i ndërpresë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe pushtetin e Komunës. Ai mund t'i refuzojë, t'i thërrasë ose t'i dëgjojë diskutuesit, të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund ta caktojë kohën e paraparë për diskutim.
8. Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë takimit publik, për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda tridhjetë (30) ditësh pas mbajtjes së takimit.
9. Për çdo takim publik mbahet procesverbali, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunalë, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.
10. Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e mbajtjes së takimit, e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në takim dhe bën rekomandimet e nevojshme, të cilat ia propozon Kuvendit të Komunës për takim e ardhshëm.
11. Kryetari i komunës apo përfaqësuesi i autorizuar i kryetarit cakton zyrtarin për mbajtjen e evidencës për numrin e pjesëmarrësve në takime publike si dhe mbajtjen e procesverbaleve.

12. Kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku gjatë takimeve evidentohen dhe publikohen në ueb faqen zyrtare të komunës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas përfundimit të takimeve publike.

Neni 91

Takime tjera konsultative

1. Përveç dy takimeve publike, Komuna mban edhe takime tjera konsultative në kuadër të lagjeve, vendbanimeve dhe lokacioneve tjera për çështje që lidhen me buxhetin e komunës, projektet e komunës, zhvillimin ekonomik lokal, përdorimin e pronës së komunës, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat e komunës si dhe çështje të tjera në interes të përgjithshëm.
2. Njoftimi për takimet e tjera konsultative behet përmes formave tjera të informimit, si ne vijim:
 - 2.1. ueb faqen zyrtare të komunës dhe rrjetet sociale;
 - 2.2. mediat e shkruara dhe elektronike; dhe
 - 2.3. në tabelat e shpalljeve brenda territorit të komunës.
3. Njoftimi i publikut përmban datën, kohën, vendin e mbajtjes së takimit dhe rendin e ditës.
4. Mbajtja e evidencës së pjesëmarrësve, procesverbalit, publikimi i rekomandimeve nga takimet konsultative është e obligueshme.

Neni 92

Konsultimi i publikut para miratimit të akteve

1. Aktet e komunës, të cilat janë në interes për qytetarët i nënshtrohen diskutimit publik para miratimit, duke përfshirë këtu edhe organizimin e debateve në vende rurale.
2. Komuna lidhur me konsultimet publike duhet të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve komunale dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023 për administratë të hapur në komun.

Neni 93

Qasja në dokumentet publike

1. Organet e komunës garantojnë informata, respektivisht qasje në dokumente publike, për personat fizik dhe juridik.
2. Zyrtari për qasje në dokumente publike bën pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumentet publike të aprovuara nga organet e komunës.
3. Nëse organet e komunës, nuk e posedojnë dokumentin e kërkuar nga parashtruesi i

kërkesës, obligohen që në afat prej pesë (5) ditë pune nga dita e pranimi të kërkesës me shkrim, t'ia përcjellë kërkesën organit përkatës.

4. Organet e komunës obligohen që brenda shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të kërkesës të nxjerrin vendim për lejin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japin përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishtë.
5. Në rast të refuzimit të kërkesës së plotë apo të pjesërishtë, parashtruesi i kërkesës mundet që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas marrjes së përgjigjes nga organet e komunës, të parashtojë kërkesën për rishqyrtimin e çështjes duke kërkuar nga organet e komunës që ta rishqyrtojë vendimin.
6. Afati për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike mund të vazhdohet deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë, në qoftë se dokumenti publik kërkohet jashtë organeve të komunës, dhe nëse përmes një kërke kërkohen disa dokumente publike.

Neni 94 Referendumi

1. Disa çështje me interes të përgjithshëm, që kanë të bëjnë me kompetencat e Komunës, për të cilat Kuvendi për arsye të ndryshme nuk merr vendim përfundimtar, atëherë organizon referendum.
2. Zhvillimi i referendumi të besohet një institucioni të kualifikuar dhe të pavarur.
3. Mënyra e organizimit të kësaj forme të deklarimit të qytetarëve rregullohet me ligj.

KAPITULLI IX

Neni 95 Autoritet mbikëqyrës

1. Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale është autoriteti mbikëqyrës, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e komunave nuk i jepet me ligj ministrisë përgjegjëse apo institucionit që ka të bëjë me lëmi të posaçme.
2. Shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar ato.

Neni 96 Përgjegjësitë e ndërsjella dhe procesi i shqyrtimit administrativ

Autoritetet komunale dhe mbikëqyrës obligohen për të bashkëpunuar me njëri tjetrin në procesin e shqyrtimit. Të gjitha masat e shqyrtimit ndërmerren nga autoritetet mbikëqyrës në bazë të akteve përkatëse administrative. Aktet e tilla ofrojnë bazën ligjore dhe shpjegojnë arsyet e zbatimit të masës së një mbikëqyrjeje të caktuar.

Neni 97

Të drejtat e autoritetit mbikëqyrës për të qenë të informuar

1. Autoriteti mbikëqyrës ka të drejtë të marrë dhe sigurojë informata të plota për të gjitha çështjet, përfshirë të drejtën për t'i vizituar zyrat komunale dhe objektet komunale dhe të drejtën për të kërkuar qasje në dokumentet komunale.
2. Kryetari i komunës është përgjegjës për t'ia vënë në dispozicion informacionet autoritetit mbikëqyrës.
3. Çdo kërkesë për dokumente i adresohet organit të qeverisjes lokale dhe shpërndarja e dokumenteve sigurohet nga kryetari i komunës në pajtim me paragrafen 1 të nenit 77 të LVL.
4. Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale ka të drejtën për të qenë e informuar rregullisht nga komuna në fushat në të cilat ministria nuk është autoritet mbikëqyrës.

Neni 98

Llojet e shqyrtimit

1. Shqyrtimi i funksionimit të komunës në fushën e kompetencave vetanake kufizohet në shqyrtimin e ligjshmërisë.
2. Shqyrtimi administrativ i funksionimit të komunës në fushën e kompetencave të deleguara i nënshtrohet mbikëqyrjes së ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë së veprimeve.

Neni 99

Shqyrtimi i rregullt i ligjshmërisë

1. Kryetari i komunës i dërgon autoritetit mbikëqyrës listën e të gjitha akteve të miratuara nga Kryetari dhe Kuvendi në muajin paraprak, deri më datën 10 të çdo muaji.
2. Autoriteti mbikëqyrës ka të drejtë të mbikëqyrë çdo akt i cili nuk është kontrolluar sipas procedurave të shqyrtimit të detyrueshëm, brenda 30 ditësh pas pranimit të listës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 100

Shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë

1. Aktet në vijim i nënshtrohen procedurës së shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë:
 - 1.1. aktet e përgjithshme të miratuara nga kuvendi i komunës;
 - 1.2. vendimet lidhur me aktivitetet e përbashkëta të partneriteteve për bashkëpunim; dhe
 - 1.3. aktet e miratuara brenda kornizës së implementimit të kompetencave të deleguara.

2. Të gjitha komunat obligohen që t'ia dorëzojnë aktet e përmendura autoritetit mbikëqyrës brenda 7 ditësh nga data e nxjerrjes së tyre.
3. Autoriteti mbikëqyrës vërteton pranimin e aktit të qeverisë lokale përmes regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës. Autoriteti mbikëqyrës është i obliguar që të japë mendimin e tij për ligjshmërinë e çdo akti të regjistruar, brenda 15 ditësh nga pranimi i tij, në pajtim me procedurat e përmendura më lartë.

Neni 101

Procedura për shqyrtimin e ligjshmërisë

1. Nëse autoriteti mbikëqyrës konsideron se një vendim apo një akt i komunës nuk është në përputhje me kushtetutën dhe ligjet, ai mund të kërkojë që komuna ta rishqyrtojë vendimin apo aktin e tillë.
2. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet e supozuara të shkeljes së kushtetutës apo ligjit dhe nuk suspendon ekzekutimin e vendimit komunal apo akteve të tjera.
3. Organi i njësisë së vetëqeverisjes lokale i përgjigjet kërkesës për rishqyrtim, brenda 30 ditësh nga data e pranimin të kërkesës.

Neni 102

Shqyrtimi i përshtatshmërisë

Shqyrtimi i aktit të komunës për kompetencat e deleguara ushtrohet nga autoriteti mbikëqyrës për kompetenca të deleguara, ashtu siç është përcaktuar në nenin 84 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale.

Neni 103

Konsultimi paraprak

1. Para nxjerrjes së një akti, organi komunal mund të kërkojë konsultim me autoritetin mbikëqyrës.
2. Kërkesa për konsultime paraprake përmban draftin e aktit që synohet të nxirret dhe çështjen e posaçme për të cilën kërkohet këshilla e autoritetit mbikëqyrës për sa i përket ligjshmërisë dhe/ose arsyeshmërisë së aktit në fjalë.
3. Autoriteti mbikëqyrës obligohet të përgjigjet me shkrim brenda 30 ditësh pas pranimin të kërkesës.

Neni 104

Ankesat e qytetarëve

Ankesat e qytetarëve kundër një akti administrativ të organeve të komunës shqyrtohen sipas

Ligjit Për procedurën e përgjithshme administrative.

KAPITULLI X

Dispozitat Përfundimtare

Neni 105

Në rast se ekziston mospërputhje në mes të dispozitave të këtij Statuti dhe Ligjit për vetëqeverisjen lokale, vlejné dispozitat ligjore.

Neni 106

Pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti pushojné së funksionuari të gjitha dispozitat e akteve të mëparshme të Komunës, në pjesët ku janë në kundërshtim me këtë Statut.

Neni 107

Pas miratimit të këtij Statuti, në afatin prej 6 (gjashtë) muajve, të gjitha aktet e Komunës harmonizohen në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.

Neni 108

Ky Statut shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Zubin Potokut.

Zubin Potok

Kryesuesi i Kuvendit

Emri dhe Mbiemri

Dorëzohet:

1x1 Kryesuesit të Kuvendit

1x1 MAPL

1x1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës